

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Aktiviteti 2.6.5: Vazhdim i përkrahjes në përpilimin e Llogarive Kombëtare në Kosovë, me fokus në SUT

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Søren Larsen
Statistikat e Danimarkës

1- 5 Shkurt 2016

IPA 2012

Emri i autorit, adresa, e-maili

*Søren Larsen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 39 83
Email: shl@dst.dk*

Përmbajtja

1. Komentet e Përgjithshme.....	4
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	4
2.1 Kodimit i burimit të dhënave.....	4
2.2 Statistikat e ASN-së për 2013.....	5
2.3 Outputi dhe inputi për NPISH.....	5
2.4 Krahasimi i burimit të dhënave për industri në total.....	6
2.5 Strukturat e produktit të outputeve dhe inputeve të industrisë.....	6
3. Konkluzionet dhe rekomandimet.....	6

Lista e Shkurtesave

CPA	Klasifikimi Statistikor i Produkteve sipas Aktivitetit në Komunitetin Ekonomik Evropian
ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NACE	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
NPISH	Institucionet Jo-Profitabile që i Shërbejnë Ekonomive Familjare
PRODCOM	Lista e Produkteve në Komunitetin Evropian
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
SUT	Tabelat Ofruese-Përdoruese
TeR	Termet e Referencës

1. Komentet e përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat'. Është misioni i gjashtë, që i kushtohet përpilimit të Tabelave Ofruese-Përdoruese për vitin 2013 në kuadër të komponentit 2 të projektit. Është vazhdim – pas një jave pauze – i misionit paraprak, i cili ka pasur për qëllim transformimin e burimeve të të dhënave në një format të standardizuar, që përdoret në kornizën Ofruese dhe Përdoruese.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

- Pasi nuk kishte të dhëna të plota të ASN 2013 për tregti dhe ndërtimtari, totalët për outputet dhe inputet e këtyre industrive ende nuk janë vlerësuar. Gjatë këtij misioni duhet të kompletohen të dhënat e ASN-së, që nevojiten për këtë qëllim.
- Outputet dhe inputet e NPISH duhet të shpërndahen sipas industrisë dhe produkteve dhe të standardizohen në të njëjtin format si inputet e tjera.
- Duhet të validohet versioni fillestar i objektivave për totalët e kolonave në SUT.
- Duhet të vazhdohet puna në strukturat e outputeve dhe inputeve të industrisë.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

2.1 Kodimi i burimit të dhënave.

Në misionet paraprake, janë koduar të dhënat për disa fusha dhe janë kthyer në një format të standardizuar për tu përdorur në kornizën e SUT. Të dhëna të tilla mbulojnë këto fusha:

- Bujqësi
- Statistikat e TVSH-së
- Statistikat e ASN-së për 2012
- Importet dhe Eksportet e mallrave
- Anketa e buxhetit të ekonomive familjare
- Inputi dhe outputi për qeverinë e përgjithshme si dhe strukturën e produkteve të detajuar për inputet e qeverisë.
- Taksat dhe subvencionet mbi distribuimin e produkteve sipas produkteve të definuara për SUT
- Statistikat PRODCOM për vitin 2014

Statistikat e ASN për vitin 2013 duhet të përdoren për vendimet mbi madhësinë e objektivave për outputin dhe inputin total të industrisë. Për shkak të të dhënave të pakompletuara në kuadër të tregtisë dhe ndërtimtarisë, të dhënat për këto industri ende kanë nevojë të korrigjohen manualisht para se të përdoren si burime për outpute dhe inpute.

2.2 Statistikat e ASN për vitin 2013.

Në misionin paraprak, statistikat e ASN janë përdorur – së bashku me statistikat e TVSH-së dhe shifrat nga llogaritë kombëtare aktuale – për vendimet mbi versionin e parë të objektivave për totalët e industrisë për prodhim dhe konsum të ndërmjetëm. Në shumicën e rasteve, nivelet e totaleve në ASN janë kredibile kur krahasohen me dy burimet e tjera. Megjithatë, vlerat për ndërtimtari dhe tregti nuk janë përdorur menjëherë, pasi shumë ndërmarrje me output të konsiderueshëm nuk kanë pasur të dhëna për blerje të mallrave apo rishtije, lëndës së parë apo inputeve të tjera. Vlerat e munguara tashmë janë imputuar duke u bazuar në të dhënat në dispozicion.

Duke analizuar të dhënat individuale në ASN, bie në sy që për shumë ndërmarrje vlera e shtuar bruto është dukshëm më e ulët se vlera e paraqitur për kompenzimin e punëtorëve. Kur ka pasur të dhëna në ASN mbi pagat dhe medijtjet, ato janë validuar duke i krahasur me burimet zyrtare dhe në përgjithësi konsiderohen të jenë të besueshme. Kjo indikon që vlera e shtuar bruto mund të jetë nënraportuar në këto raste. Edhe pse viti 2013 konsiderohet të ketë qenë qenë vit i krizës ekonomike, supozohet që vlera e shtuar bruto e 'vërtetë' e mbulon kompenzimin e punëtorëve, ndoshta edhe konsumin e kapitalit fiks. Përshtatim mund të jenë ndërmarrjet, të cilat janë duke e shitur inventarin e tyre të pakësuar dhe duket që janë duke u mbyllur. Pavarësisht mundësisë që disa ndërmarrje kanë humbje të konsiderueshme, vlera e prodhimit duhet – si rregull i përgjithshëm – të rritet aq sa është e nevojshme për të eliminuar vlerat negative të tepërës operacionale/të hyrat e kombinuara.

Për secilën industri do të kalkulohet një shtesë për nën raportimin, si një korrigjim i vlerës së prodhimit, bazuar në statistikat e ASN dhe/ose TVSH-së.

Nën raportimi sipas njësive, që mbulohen nga statistikat ose të dhënat administrative, është një nga komponentet e korrigjimit për aktivitetet e pavrojtura. Në mënyrë ideale, duhet të shtohet një shtojcë për aktivitetin në njësitë, që nuk mbulohen nga ndonjë prej këtyre burimeve. Aktualisht, nuk ekziston një qasje sistematike e përfshirjes së këtij nën vlerësimi në Kosovë. Për disa industri, shifrat nga llogaritë kombëtare aktuale janë më të larta se vlerat sipas disa burimeve tjera. Kjo mund të interpretohet si një nevojë për të bërë disa përshtatje për aktivitetin e pavrojtuar. Gjatë balancimit të ofertës dhe përdorimit po ashtu mund të shtohen disa shtojca, për të mbuluar përdorimin, vlerat e të cilit kalkulohen nga ana përdoruese.

Është vendosur të mos përdoren informatat mbi strukturat e detajuara të produkteve nga ASN 2013, pasi vetëm pak ndërmarrje kanë ofruar këto të dhëna dhe duket që statistikat PRODCOM janë më të besueshme për këto struktura.

2.3 Outputi dhe inputi për NPISH.

Llogaritë kombëtare përmbajnë një tabelë me kalkulimet për sektorin NPISH në tërësi. Secila njësi e NPISH tani ka kodin e industrisë 2 shifror, outputi i tij është i koduar si lloje të ndryshme të të ardhurave nga shitja dhe /ose outputi final jo-profitabil. Në këtë proces është zbuluar që kostoja e disa aktiviteteve nuk është përfshirë në vlerën origjinale të outputit. Në disa raste kjo mund të arsyetohet, si mënyrë për t'iu shmangur numërimit të dyfishtë, në rastet e tjera me siguri do të rezultojë në nën vlerësim të prodhimit të NPISH. Në anën tjetër, është diskutuar nëse janë bërë disa numërime të dyfishta për shkak të mbivendosjes midis NPISH dhe aktiviteteve të tregut. Gjatë misionit, është hartuar versioni i parë i dokumentit por versioni final duhet të përfundohet para misionit të radhës.

2.4 Krahassimi i burimit të dhënave për industrinë në total.

Në misionin paraprak, janë hartuar më shumë tabela për krahasim midis vlerave të gjetura në llogaritë kombëtare ekzistuese, statistikën e TVSH-së, statistikën e ASN-së, llogaritë qeveritare dhe të dhënat e bujqësisë për vitin 2013. Është bërë versioni i parë i vlerave të synuara për outputin dhe inputin e secilës industri me përjashtim të tregtisë me shumicë dhe pakicë dhe pjesën e outputit dhe inputit të NPISH në ato industri, që përmbajnë aktivitete jo-profitabile.

Misioni aktual ka rezultuar në disa informata shtesë, që pak a shumë kanë pasur ndikim në secilën prej objektivave në përgjithësi. Korrigjimet e mëtejme në ASN 2013 do të ndryshojnë konkluzionet mbi madhësinë e disa industrive dhe tani duhet të jetë e mundur të prodhohen vlerësimet që mungojnë për tregti dhe ndërtimtari. Shtesat e vlerësuara për nën-raportim do t'i shtohen vlerave të prodhimit në, ku komponentet e objektivave për totale e kolonave janë vendosur së bashku. Gjithashtu, bëhen rregullimet/korrigjimet për ndryshimet konceptuale midis llogarive kombëtare dhe kontabilitetit të biznesit. Kjo duhet të kompletohet në fillim të misionit të radhës.

2.5 Strukturat e produktit të outputeve dhe inputeve të industrisë.

Përveç industrive të lartpërmendura, ku mungojnë të dhëna, është përgatitur një matricë e e anës ofruese gjatë misionit paraprak. Kjo matricë do të përmirësohet në rast të ndonjë ndryshimi në totale e industrisë.

Për industrinë e mbuluar nga PRODCOM, kodimi i produktit të konsumit të ndërmjetëm është validuar dhe tani duhet po ashtu të korrespondojë me klasifikimin e përdorur në SUT. Janë bërë disa punë shtesë për të ofruar vlera të paracaktuara për përdorim të inputeve, që nuk janë specifikuar në burimin e të dhënave nga statistikën e bujqësisë, PRODCOM ose llogarive qeveritare, por të dhënat duhet të bëhen bashkë nga burime të ndryshme. Në fillim të misionit të radhës do të krijohet versioni i parë i anës ofruese tërësisht i populluar. Kjo kërkon angazhimin e konsulentit edhe gjatë dy javëve të ardhshme.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Pasi të ngriten statistikën PRODCOM në një standard të përshtatshëm për përdorim në përpilimin e SUT, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet atyre pjesëve të ASN, që nevojiten për kalkulimin e shifrave për tregti dhe ndërtimtari. Përsëri, kërkohet një angazhim i konsiderueshëm para se të imputohen vlerat e blerjes së mallrave për rishitje dhe konsum të ndërmjetëm të disa ndërmarrjeve, të cilat nuk janë përgjigjur në pyetësor. Në mënyrë të veçantë ky imputim është i rëndësishëm për industrinë e tregtisë. Vetëm statistikën e TVSH-së nuk mund të ofrojnë informata për outputet dhe inputet nëse nuk kemi njohuri për pjesën e blerjeve, që përdoren për mallra për rishitje dhe konsum të ndërmjetëm.

Gjatë analizimit të ASN, është vërejtur qartë që qarkullimi i shumë ndërmarrjeve nën-raportohet. Është hartuar një plan për përmirësimin e totalit të outputit për disa industri. Konsulenti duhet të përfundojë disa gjëra shtesë lidhur me këto, para misionit të radhës.

Për shkak të vonesave më herët, mbetet që çështjet e pazgjidhura në procesin e përpilimit të SUT të zgjidhen në një kohë relativisht të shkurt. Pas misionit të kaluar është rekomanduar që dy misionet e radhës të caktohen në shkurt. Duhet kohë e mjaftueshme për të përgatitur të dhënat SUT për

balancimin e anës ofruese dhe përdoruese dhe finalizimin e SUT. Prandaj, është propozuar që misioni i radhës dhe i fundit të mbahet me 22 Shkurt deri me 4 Mars, me 2 konsulentë gjatë javës së dytë të misionit.



Termat e Referencës:

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Aktiviteti 2.6.5: SUT aktiviteti V.

Vazhdim i përkrahjes në përpilimin e llogarive kombëtare në Kosovë, me fokus në SUT

Orari:

TeR –data e përgatitjes: 25 Janar 2016

Fillimi / fundi i aktivitetit: 1-5 Shkurt 2016

Koha e raportimit: 12 Shkurt 2016

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultati obligativ	Intervenimi logjik	Pikë referimi	Burimi i informacionit	Sugjerimet
2.3.1	Përkrahje në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Përkrahja finale në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare	- Raportet e misioneve, të publikuar në faqen e internetit të projektit - Fushat e caktuara të Llogarive Kombëtare, të përditësuara sipas ESA2010	- Raportet tremujore të projektit të Binjakëzimit - Raporti i Misionit - Plani i veprimit, i përditësuar	- Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e dytrave, që lidhen me projektin në mes të misioneve - Qasje në statistikat primare të sakta - Termat e referencës, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat, rezultatet e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe agjendën

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.6.5

Përkrahja në përpilimin e Llogarive Kombëtare në Kosovë. Fokus në Tabelat ofruese-përdoruese (SUT). Ky mision është vazhdimësi e misionit me Z. Søren Larsen, Jens Holst Jensen 2.6.4 në Janar 2015. Misioni në Dhjetor ka konkluduar që:

Në fillim të aktivitetit 2.6.4 të dhënat e qeverisë së përgjithshme janë sjellë në pikën, ku të dhënat e inputeve dhe outputeve janë azhurnuar, koduar dhe janë futur në kornizën SUT nga stafi i ASK-së.

Të dhënat nga Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare kanë kaluar nëpër procedurën e korrigjimit, për t'i përmbledhur siç ka qenë e planifikuar në fund të misionit paraprak.

Puna në ASN dhe PRODCOM ka vazhduar para dhe gjatë misionit në Janar. Akoma ka nevojë për korrigjime të gabimeve në kuadër të disa fushave në statistikat e ASN-së, të dhënat e PRODCOM për outputet dhe inputet e industrisë tani janë korrigjuar dhe janë në formë të përshtatshme për shpërndarjen e outputeve dhe inputeve të industrisë sipas produkteve.

Të dhënat e ASN-së në kombinim me statistikat e TVSH-së janë burim i rëndësishëm për outputin dhe inputin në total, për këto industri që mbulohen nga këto statistika. Burimet tani janë krahasuar me njëri tjetrin dhe me vlerat korresponduese prej llogarive kombëtare ekzistuese. Objektivat fillestare për outputet janë zgjedhur për shumicën e industrive dhe është vendosur shpërndarja e outputit sipas industrive. Të dhënat e detajuara të industrisë për tregti që do të përdoren për të vendosur shpërndarjen e marzhave të tregtisë sipas produkteve, megjithatë, duhet të vendosen gjatë misionit të radhës.

Statistikat e TVSH-së do të krijojnë bazën për shpërndarjen e TVSH-së të pazbritshme sipas produkteve dhe industrive. Gjatë misionit të radhës, modeli i përdorur për shpërndarjen e TVSH-së të pazbritshme duhet të përmirësohet bazuar në të dhënat e TVSH dhe legjislacionit.

Duke vënë së bashku të gjitha informatat mbi outputet, inputet dhe përdorimin final, si dhe shpërndarjen e marzhave të tregtisë, taksave dhe TVSH, ende duhet të presim derisa të dhënat e fundit mbi inputet të jenë të gatshme. Balancimi i anës ofruese dhe përdoruese nuk mund të realizohet para se të popullohet tërësisht me të dhëna korniza e SUT. Pas këtij misioni do të ketë dhe një mision tjetër në fund të Shkurtit 2016, kur do të balancohet ana ofruese dhe përdoruese.

Planet që nevojiten për misionin në vijim

Veprimi	Afati kohor	Personat përgjegjës
<i>Korigjimi i të dhënave të ASN 2013 për tregti.</i>	<i>Para misionit të radhës</i>	<i>Ekspertët danezë.</i>
<i>Të dhënat e mbetura që nevojiten për strukturat e inputit duhet të përgatiten para përdorimit.</i>	<i>Para misionit të radhës</i>	<i>Ekspertët danezë.</i>

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.6.5:

Raporti i misionit, që përshkruan rezultatet e kodimit të dhënave, që do të përdoren për SUT

Rekomandimet për përfundimin e SUT në ASK

Përshkrimi i punës së bërë gjatë misionit dhe punës që duhet bërë para fillimit të aktiviteti të radhës

Stafi i ASK-së:

Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevdie.Fetahu@rksgov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florije Krapi, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapi@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Z. Søren Larsen, Ekspert i LLK, Statistikat e Danimarkës, shl@dst.dk

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA), i përgatitur nga Eurostat-i, deklaron në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK-ja, me mbështetjen e IPA-s, ka përgatitur një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave gjithëpërshirëse për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare, së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

Projekti i Binjakëzimit deri tani ka pasur disa aktivitete në Komponentin #2 Llogaritë Kombëtare përfshirë misionin e gjetjes së fakteve mbi SUT

Aktivitetet, që duhet të ndërmerren në përgatitje të misionit:

- Raportet e misionëve të kaluara në komponentin e LLK. Të gjitha të publikuara në www.dst.dk/kosovo

Aktivitetet e pritura janë:

- Azhurnimi i planit të veprimit për përmirësimin e Llogarive Kombëtare me SUT
- Zhvillimi i planit të detajuar për veprimet e ardhshme mbi SUT nga programi i binjakëzimit
- Kodimi i të dhënave

Rezultatet e pritura janë:

- Raporti i misionit – sipas modelit
- Plani i detajuar për aktivitetet e mëtejme në komponentin 2 nga programi i binjakëzimit
- Versioni i azhurnuar i planit për SUT
- Lista e veprimeve që duhet të ndërmerren para misionit të ardhshëm

Aneksi 1. Programi, Shkurt 2016

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	10:00	ASK: Rishikim i punës së bërë nga misioni i kaluar mbi SUT në Janar 2016
		10:45	Pushim për kafe
		11:00	Diskutimi mbi planet për këtë javë
		12:00	Dreka
		13:30-15:30	Punë praktike me të dhënat për SUT
2	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
3	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
4	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT Diskutimi mbi rekomandimet Plani për misionin e ardhshëm dhe si të veprohet para misionit të radhës Shkrimi i raportit
5	ASK	10:00-12:00	Shkrimi i raportit Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA